

REPUBLIKA E KOSOVËS			
KOMUNA GLLOGOC			
GLLOGOC MUNICIPALITY			
PRANUAR	13/12	2024	
Nj. Org.	Numër	Shtojca	Vlera
01-030/01	59313		



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA DRENAS



Zyra e Kryetarit

Drenas, 11 dhjetor 2024

Për: KKSB-në

Lënda: Plani i punës për vitin 2025 i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij udhëzimi puna e KKSB-së duhet bazohet gjithmonë në dispozitat që rregullojnë çështjen e funksionimit si një organ këshillues për çështjet e sigurisë në bashkësi me përfaqësim të gjerë të gjitha komuniteteve dhe përfaqësuesve të shoqërisë civile.

Plani i mëposhtëm përfshin objektivat kryesore, aktivitetet, bartësit e aktiviteteve, dhe afatet kohore.


Qëllimi planit është përmirësimi i sigurisë publike dhe ndërtimi i një komuniteti më të sigurtë si dhe rritja e bashkëpunimit mes institucioneve, qytetarëve dhe palëve të interesuara për sigurinë në komunitet.

PLANI I PUNËS SË KKSBB-SË PËR VITIN 2025

Nr. rend or	Objektiva	Aktiviteti	Afati	Bartës i aktivitetit
1.	Rritja e vetëdijesimit të qytetarëve lidhur me natyrën e krimeve, parregullsitë dhe sjelljet e dhunshme në komunitetin lokal	➤ Fushata Informuese ➤ Takime dhe diskutime me komunitetin ➤ Programet Edukative në Shkolla ➤ Angazhimi i autoriteteve dhe institucioneve lokale ➤ Aktivitete tjera ndërgjegjëse	Janar-Dhjetor 2025	KKSBB/KLSP/ ZBGJ/OJQ/Drejtoritë komunale
2.	Identifikimi i brengave lidhur me sigurinë publike	➤ Mbledhja e të dhënave nga burimet e ndryshme ➤ Organizimi i takimeve të rregullta ➤ Inspektimi dhe vlerësimi i gjendjes në terren, pra të infrastrukturës publike ➤ Bashkëpunimi me akterë tjerë të sigurisë si Policia dhe Institucionet e Zbatimit të Ligjit, Institucionet arsimore dhe Organizatat Rinore; Organizatat joqeveritar dhe fetare	Janar-Dhjetor 2025	KKSBB/KLSP/ZBGJ/OJQ Drejtoritë komunale

3.	Rekomandimi i planeve të veprimit dhe adresimi i brengave të qytetarëve te autoritetet komunale	➤ Mbledhjet e KKSB-së ➤ Mbledhjet e KLSP-së ➤ Mbledhjet e Bordit të Drejtorëve ➤ Mbledhjet e Kuvendit Komunal	Janar-Dhjetor 2025	KSB/KLSP/ZBGJ/OJQ/Drejtoritë komunale
4.	Ndërtimi i besimit në mes të policisë dhe qytetarëve nëpërmjet ndërtimit të partneritetit dhe iniciativave të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve të sigurisë në çdo bashkësi	➤ Takime të rregullta komunitare ➤ Përfshirja e qytetarëve në vendimarrje ➤ Iniciativa të përbashkëta për zgjidhjen e problemeve ➤ Programe për forcimin e partneritetit ➤ Përdorimi i teknologjisë për të ndërtuar besimin ➤ Aktivitete të përbashkët me organizatat në Drenas	Janar-Dhjetor 2025	KSB/KLSP/ZBGJ/OJQ/Drejtoritë komunale

5.	Përfaqësimi i pikëpamjeve dhe shqetësimeve të të gjithë qytetarëve, për çështjet e krimit dhe për çështjet tjera që lidhen me kualitetin e jetës	➤ Përfshirja e të gjithë grupeve të komunitetit ➤ Organizimi i forumeve dhe platformave të hapura ➤ Promovimi i përfaqësimit të barabartë ➤ Përfshirja e qytetarëve në zgjidhjen e problemeve	Janar-Dhjetor 2025	KSB/KLSP/ZBGJ/ OJQ/Drejtoritë komunale
----	--	--	-----------------------	--



Kryetar i Komunës

Ramiz Lladrovci